

Në kuadër të aktiviteteve, dhe takimeve në Javën e Europës, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare AIIS, Tiranë, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Sociale, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, zhvilluan **lektoriumin: “Akademia e Europës”** si dhe disa takime të rëndësishme, ku veçojmë takimin përmbyllës të studentëve pjesëmarrës në Akademinë e Europës, me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara Donald Lu.

Temat e lektoriumit u punuan dhe prezantuan nga pedagogë të Departamentit të Shkencave Sociale dhe Departamentit të Filozofisë, FSHS, Universiteti i Tiranës, përballë një auditori me studentë pjesëmarrës. Temat e trajtuara sollën në diskutim disa çështje shumë të rëndësishme aktuale të Bashkimit Europian dhe sfidat integruese të vendit tonë.

Programi i Lektoriumit: Akademia e Europës, 11-15 maj 2015

1. Dt.11.05.2015

Prof.dr.Gjergji Pendavinji: “ *Reforma arsimore europiane dhe disa aspekte reformuese të Arsimit të Lartë në Shqipëri*” .

2. Dt.12.05.2015

Dr. Magdalini Vampa: “ *Teoria e ‘paqes së përjetëshme’ dhe Bashkimi Europian*”.

3. Dt.13.05.2015

Doc.Ardian Matka: “ *Vlerat etiko-fetare, element i rëndësishëm drejt integrimit europian*”.

4. Dt.14.05.2015

Doktorante Maria Dojçe: “ *Nevoja për universalizimin e vlerave kulturore në kuadër të integrimit të Shqipërisë në BE*”.

5. Dt.15.05.2015

Prof.dr.Gjergj Sinani: “ *Parimet e Demokracisë Europiane*”.